

KONTRATË  
MBI "THEMELIMI E SHOQËRISE SË THJESHTË"  
"Dedic8edSoft"

Sot, me datë 17/01/2024, në Shkodër, Shqipëri, personi i mëposhtëm:

**Znj Paskualina Gjoni**, shtetase shqiptare, lindur më 16/04/1995 lindur dhe banuese në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me numër **J55416078W**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

dhe **Znj. Alesia Laloshi**, shtetase shqipëtare, lindur me 10/06/2000 lindur dhe banuese në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me numër **K05610079C**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, vendosën të themelojnë një shoqëri të thjeshtë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

**TË PËRGJITHSHME**

Ky akt rregullon pozitën juridike, marrëdhëniet e anetarëve themelues, marrëdhëniet e organeve të saj, llojin e partneritetit, kohëzgjatjen e veprimtarisë së shoqërisë së thjeshtë, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile.

**NENI 1**

Emri i shoqërisë së thjeshtë është " **Dedic8edSoft** ", këtu e më poshtë e quajtur "**Shoqëria**". Shoqëria është person juridik privat.

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim, mes të tjerave, fitimin. Shoqëria organizohet në formën e shoqërisë së thjeshtë. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të kësaj kontrate themelimi dhe të legjislacionit në fuqi.



## NENI 2

### Adresa e shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresen: **Ndertesa me nr. Pasurie 1/342-N23, Lagjja Vasil Shanto, Rruga Qemal Draçini, zona kadastrale 8593, Shkoder 4001.**

Shoqëria mund të hapë degë përfaqësimi në qytetet e tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

## NENI 3

### Objekti

Objekti i shoqërisë do të jetë;

Krijim website dhe zhvillim software. Shërbime të tjera në fushën e IT.

## NENI 4

### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pakufizuar, duke filluar nga data e rregjistrimit në QKB.

## NENI 5

### Kapitali Themelor dhe Ortakët

Kapitali i Shoqërisë është 100 000 Lekë (katërqind mijë).

Kapitali është shlyer nga anëtarët themelues në raportet e mëposhtme;

-nga Znj. Paskualina Gjoni, 90% e kapitalit, me 1 kuotë, 90 000 lek kapital  
-nga Z. Alesia Laloshi, 10% e kapitalit, me 1 kuotë, 10 000 lek kapital

Kapitali themelor është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Anëtarët me themelimin e Shoqërisë.

**NENI 6**  
Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi me i lartë vendim-marrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e kësaj Kontrate, janë të detyrueshme për të gjithë Anëtarët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

**NENI 7**  
Administratori

Shoqëria administrohet nga një ose me shumë administrator/e, i/të emeruar nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori i parë i Shoqërisë është:

**Znj. Alesia Laloshi, shtetase shqipëtare, lindur me 10/06/2000 lindur dhe banuese në Shkodër, mbajtës i letërnjoftim me numër K05610079C, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar,**

Mandati i Administratorit është për një periudhe prej 5 (pesë) vitesh, nga data **17.01.2024 – 17.01.2029**. I rinovueshem, dhe, nese është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri. Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit, të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.



**NENI 8**  
**Viti Financiar**

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të cdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik, Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet ne fuqi.

Përfundimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon me 31 Dhjetor 2023.

**NENI 9**  
**Të ndryshme**

Kjo Kontratë Themelimi është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjten vlerë secila.

**ORTAKËT E SHOQËRISË**

Paskualina Gjoni

*Paskualina Gjoni*



Alesia Laloshi

*Alesia Laloshi*

